



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 gusht 2010) si dhe neni 103, paragrafi 2, dhe neni 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 27 dhjetor 2018, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë parimet bazike mbi organizimin dhe operimin e kontrolleve të brendshme dhe funksionin e auditimit të brendshëm të institucioneve financiare jobankare (në vijim: IFJB).
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha IFJB-të e regjistruara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të IFJB-ve të regjistruara me aktivitet të vetëm këmbimin e valutave, për të cilat dispozitat e kësaj rregullore aplikohen vetëm me kërkesë të veçantë të BQK-së.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB) ose sipas përkufizimeve në vijim, për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1 *Sistemi i Kontrolleve të Brendshme* - do të thotë procesi i monitoruar nga bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë dhe personeli tjetër, i themeluar për të ofruar siguri të arsyeshme lidhur me arritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve, besueshmërinë e raportimit dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në zbatim.
 - 1.2 *Funksioni i Auditimit të Brendshëm* - është një aktivitet i pavarur, objektiv dhe këshillues, i themeluar për ngritjen e vlerave dhe përmirësimin e operacioneve të IFJB-së. Ky funksion ndihmon në arritjen e objektivave duke ofruar një qasje sistematike

dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, të kontrollit dhe proceseve qeverisëse.

Neni 3 Kërkesat

1. IFJB-të duhet të sigurojnë një sistem efikas të kontrollit të brendshëm me qëllim të parandalimit të humbjeve, mirëmbajtjen e raportimit të besueshëm financiar dhe të menaxhmentit, zgjerimin e operimit të tyre të matur dhe promovimin e stabilitetit në sistemin financiar të Republikës së Kosovës.
2. BQK-ja kërkon nga IFJB-të, të kenë një sistem efektiv të kontrolleve të brendshme që është në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rrezikun e mundshëm në aktivitetet brenda dhe jashtë bilancit të gjendjes dhe që kjo t'i përgjigjet ndryshimeve në ambientin dhe kushtet e tyre.
3. Qëllimet e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jenë parandalimi i mashtrimeve, shpërdorimeve dhe veprimeve të gabuara, si dhe zvogëlimi i rreziqeve tjera të ballafaquara nga IFJB-ja, në mënyrë që të:
 - 3.1 Nxisin efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve dhe masave të cilat e mbrojnë IFJB-në në përdorimin e pasurive dhe resurseve tjera dhe në mbrojtjen nga humbjet;
 - 3.2 Sigurojnë besueshmëri dhe saktësi të informacioneve financiare dhe të menaxhmentit, ashtu që menaxherët e lartë, drejtorët, aksionarët, palët e jashtme dhe mbikëqyrësit të mund të mbështeten në to për vendimmarrje; dhe
 - 3.3 Sigurojnë pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
4. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm përbëhet nga komponentët e ndërlidhur në vijim:
 - 4.1 Drejtimi, mbikëqyrja dhe kultura e kontrollit;
 - 4.2 Njohja dhe vlerësimi i rrezikut;
 - 4.3 Kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave;
 - 4.4 Informimi dhe komunikimi; dhe
 - 4.5 Monitorimi i aktiviteteve dhe korigjimi i mangësive.

Neni 4 Mbikëqyrja dhe kultura e kontrollit - Përgjegjësitë e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë

1. Bordi i drejtorëve dhe administratorët e lartë janë përgjegjës për promovimin e standardeve të larta të etikës dhe integritetit dhe për vendosjen e një kulture brenda organizatës e cila thekson dhe demonstroi rëndësinë e kontrolleve të brendshme për të gjitha nivelet e

- personelit. Menaxherët e lartë duhet të sigurojnë që i gjithë personeli të kuptojë rolin e tyre në procesin e kontrollit të brendshëm dhe që do të jenë plotësisht të përfshirë në këtë proces.
2. Bordi i drejtorëve është përgjegjës për drejtimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e IFJB-ve dhe për të siguruar që punët janë duke u kryer në interesin më të mirë të institucionit. Bordi i drejtorëve është i obliguar të veprojë me kujdes në përmbushjen e detyrës me rëndësi të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve të menaxhmentit, duke siguruar që operacionet ditore të institucionit janë në duar të menaxhmentit të kualifikuar, të ndershëm dhe kompetent.
 3. Detyrat specifike të bordit të drejtorëve mbi kontrollet e brendshme përfshijnë:
 - 3.1 Të miratojë dhe rishikojë, së paku në baza vjetore, strategjitë gjithëpërfshirëse të biznesit dhe politikat e rëndësishme të institucionit;
 - 3.2 Të vendosë për strukturën e IFJB-së dhe administrimit e IFJB-së, përfshirë njësitë operative dhe administrative, funksionet dhe pozitat mbikëqyrëse;
 - 3.3 Të krijojë, komitetin i cili mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm siç përcaktohet me nenin 98 të Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB dhe të sigurojë funksionimin e tij.
 - 3.4 Të kuptojë rreziqet kryesore të ballafaquara nga institucioni, të vendosë nivele të pranueshme për këto rreziqe dhe të sigurojë se menaxhmenti i lartë e mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - 3.5 Të rishikojë së paku një herë në vit funksionin e auditimit të brendshëm;
 - 3.6 Të sigurojë se sistemi efektiv i kontrolleve të brendshme është themeluar dhe mirëmbajtur.
 4. Menaxherët e lartë janë përgjegjës për kontrollet organizative dhe procedurale të IFJB-ve dhe për të përmbushur këtë përgjegjësi, duke siguruar integritetin e kontrolleve të brendshme dhe duke vendosur një ekip efektiv të menaxhmentit, i cili karakterizohet nga një kulturë e kontrollit dhe që është përgjegjës për përmbushjen e përgjegjësisë së tij.
 5. Detyrat specifike të kontrollit të brendshëm të menaxherëve të lartë do të jenë:
 - 5.1 Të zbatojë strategjitë dhe politikat e miratuara nga bordi i drejtorëve;
 - 5.2 Të zhvillojë proceset të cilat identifikojnë, matin, mbikëqyrin dhe kontrollojnë rreziqet e shkaktuara nga institucioni;
 - 5.3 Të mirëmbajë një strukturë organizative e cila në mënyrë të qartë përcakton përgjegjësitë, autoritetin dhe marrëdhëniet e raportimit;
 - 5.4 Të sigurojë që përgjegjësitë e deleguara të përmbushen në mënyrë efektive, të vendosë politika të duhura të kontrollit të brendshëm dhe të monitorojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - 5.5 Të sigurojë që shërbimet e kontraktuara të çfarëdo lloji të jenë me kompani të cilat kanë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm. Kontratat për shërbimet e kontraktuara duhet të përcaktojnë se auditorët e jashtëm, auditorët e brendshëm dhe ekzaminerët e BQK-së të kenë qasje në çfarëdo lloj dokumentacioni ose burim

informacioni ose sistemi që mund të kërkohet në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse.

Neni 5

Njohja dhe vlerësimi i rrezikut

1. Të gjitha rreziqet materiale të cilat mund të kenë ndikim të pafavorshëm në arritjen e synimeve të IFJB-së, duhet të njihen dhe të vlerësohen vazhdimisht. Ky vlerësim duhet të mbulojë të gjitha rreziqet me të cilat përballet IFJB-ja (përfshirë rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe rrezikun e reputacionit) varësisht nga aktivitetet për të cilat është regjistruar.
2. Kontrollat e brendshme duhet të rishikohen së paku çdo vit, nga Bordi i Drejtorëve dhe/ose Komiteti i Auditimit për të adresuar në mënyrë të duhur ndonjë rrezik të ri dhe të pakontrolluar më parë.
3. Vlerësimi efektiv i rrezikut duhet të identifikojë dhe të marrë parasysh faktorët e brendshëm (siç janë ndërlikueshmëria e strukturës organizative, natyra e aktiviteteve, cilësia e personelit, ndryshimet organizative dhe lëvizjet e stafit) si dhe faktorët e jashtëm (siç janë ndryshimi i kushteve ekonomike, ndryshimet në industri dhe avancimet teknologjike) të cilat mund të cenojnë arritjen e synimeve të institucionit.
4. Vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet në të gjitha nivelet e bizneseve individuale dhe përmes spektrit të gjerë të aktiviteteve. Vlerësimi i rrezikut duhet të adresojë aspektet e matshme dhe jo të matshme të rrezikut dhe duhet të peshojë kostot e kontroleve përkundrejt benefiteve që ato sigurojnë.
5. Procesi i vlerësimit të rrezikut do të përfshijë vlerësimin e rreziqeve, për të përcaktuar se cilat janë të kontrollueshme nga institucioni dhe cilat jo. Për ato rreziqe që janë të kontrollueshme, IFJB-ja duhet të vlerësojë nëse duhet të pranojë ato rreziqe ose masën deri në të cilën dëshiron të zvogëlojë rreziqet përmes procedurave kontrolluese. Për rreziqet e pakontrollueshme, institucioni duhet të vendosë nëse do të pranojë këto rreziqe, apo do të pushojë ose zvogëlojë aktivitetet afariste të lidhura me këto rreziqe.

Neni 6

Kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave

1. Aktivitetet e kontrollit duhet të jenë pjesë përbërëse e aktiviteteve ditore të IFJB-së. Menaxhmenti i lartë duhet të themelojë një strukturë të përshtatshme të kontrollit, me aktivitetet e kontrollit të përcaktuara në çdo nivel të biznesit, duke përfshirë: rishikime të nivelit të lartë, aktivitete të përshtatshme të kontrollit për departamente dhe njësi të ndryshme, kontrole fizike, kontrolli për pajtueshmëri me limitet e ekspozimit dhe përcjellja e mospajtueshmërisë, një sistem të aprovimeve dhe autorizimeve, si dhe një sistem të verifikimeve dhe bashkërenditjeve.

2. Aktivitetet e kontrollit duhet të dizajnohen dhe të zbatohen për të adresuar rreziqet e identifikuara nga IFJB-ja përmes procesit për vlerësimin e rrezikut. Aktivitetet e kontrollit duhet të përmbajnë dy hapa:
 - 2.1 Nxjerrjen e politikave dhe procedurave të kontrollit; dhe
 - 2.2 Verifikimi se këto politika dhe procedura janë duke u zbatuar.
3. Aktivitetet e kontrollit duhet të përfshijnë të gjitha nivelet e personelit të institucionit, prej menaxhmentit të lartë deri te personeli i linjës së parë.
4. Detyrat duhet të shpërndahen në mënyrë të duhur dhe personelit nuk duhet t'i caktohen përgjegjësitë që rezultojnë me konflikt të interesit. Fushat e konflikteve të mundshme duhet të identifikohen, minimizohen dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe të pavarur, veçanërisht në ato raste të lidhura me miratimin dhe pagesën e fondeve, vlerësimin e llogarive të klientëve dhe atyre private, mbikëqyrjen e kredive, si dhe çdo fushë tjetër ku shfaqen konflikte të interesit të rëndësishme dhe nuk zvogëlohen nga faktorë të tjerë.

Neni 7

Informimi dhe komunikimi

1. Menaxhmenti duhet të mbledhë, regjistrojë dhe mbajë të dhëna të brendshme adekuate dhe gjithëpërfshirëse financiare, operative dhe të pajtueshmërisë, si dhe informacione të jashtme të tregut lidhur me ngjarjet dhe kushtet të cilat janë relevante për vendimmarrje. Informacionet duhet të jenë të besueshme, në kohë dhe të arritshme, si dhe të mbajtura në një format të qëndrueshëm.
2. Sistemet e informacioneve duhet të jenë të besuara dhe adekuate, për të mbuluar të gjitha aktivitetet e rëndësishme të IFJB-së. Këto sisteme, përfshirë ato të cilat mbajnë dhe përdorin të dhëna në formë elektronike, duhet të jenë të siguruara dhe të mbikëqyrura nga menaxhmenti i IFJB-së në mënyrë të pavarur si dhe të mbështetura me plane adekuate në raste emergjente.
3. Menaxhmenti duhet të mbajë kanale efektive të komunikimeve për të siguruar që stafi kupton në tërësi dhe mbështet politikat dhe procedurat të cilat ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe se informacionet tjera relevante i komunikohen personelit të duhur.

Neni 8

Monitorimi i aktiviteteve dhe korrigjimi i mangësive

1. Efektiviteti i përgjithshëm i kontrolleve të brendshme të IFJB-së duhet të monitorohet nga menaxhmenti në vazhdimësi. Monitorimi i rreziqeve kryesore duhet të jetë pjesë e aktiviteteve ditore për të gjitha fushat operationale dhe afariste të IFJB-së. Procesverbalet e mbledhjeve të bordit të drejtorëve duhet të regjistrojnë vendimet e adaptuara lidhur me mangësitë e kontrollit të brendshëm.
2. Rregullat e brendshme duhet të vendosin linja të qarta të përgjegjësisë për çdo fushë operationale dhe afariste. Rishikime periodike dhe të ndara duhet të kryhen nga fushat

operacionale dhe afariste dhe të raportohen mangësitë e kontrollit të brendshëm në baza të caktuara kohore tek niveli i duhur i menaxhmentit dhe të adresohen me përpikëri. Mangësitë materiale në kontrollin e brendshëm duhet të raportohen tek menaxherët e lartë, komiteti i cili mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm dhe bordi i drejtorëve.

3. Kontrolli i brendshëm adekuat brenda IFJB-ve duhet të plotësohet me një funksion efektiv të auditimit të brendshëm, i cili në mënyrë të pavarur vlerëson sistemin e kontrollit të institucionit. Një auditim i brendshëm gjithëpërfshirës dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të kryhet nga stafi operacionalisht i pavarur, i trajnuar në mënyrë të duhur dhe kompetent.

Neni 9

Funksioni i auditimit të brendshëm

1. Funksioni i auditimit të brendshëm është pjesë e një monitorimi të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit, i cili siguron një vlerësim të pavarur të adekuatshmërisë dhe pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e vendosura të institucionit. Si i tillë, funksioni i auditimit të brendshëm ndihmon menaxherët e lartë dhe bordin e drejtorëve në kryerjen efikase dhe efektive të përgjegjësisë të tyre. Çdo IFJB duhet të ketë funksion të auditimit të brendshëm apo ky funksion të kryhet nga kontraktimi i auditimit të brendshëm, i cili do të mbikëqyret nga komiteti përkatës sipas nenit 4, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, të kësaj rregulloreje.
2. Fushëveprimi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përfshijë:
 - 2.1 Ekzaminimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
 - 2.2 Rishikimin e aplikimit dhe efektivitetin e procedurave për menaxhimin e rrezikut dhe metodologjive për vlerësimin e rrezikut;
 - 2.3 Rishikimin e sistemeve të menaxhmentit dhe të informacioneve financiare;
 - 2.4 Rishikimin e saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrave të kontabilitetit dhe të raporteve financiare;
 - 2.5 Rishikimin e mënyrave të ruajtjes së aseteve;
 - 2.6 Testimin e transaksioneve dhe funksionimin e procedurave specifike të kontrollit të brendshëm;
 - 2.7 Rishikimin e sistemeve të themeluara për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore, kodin e sjelljes dhe implementimin e politikave dhe procedurave;
 - 2.8 Testimin e besueshmërisë dhe përpikërisë së raportimeve rregullatore;
 - 2.9 Kryerjen e detyrave specifike të auditimit.
3. Menaxhmenti i lartë është përgjegjës të sigurojë që funksioni i auditimit të brendshëm të mbahet plotësisht i informuar lidhur me zhvillimet e reja, iniciativat, produktet dhe ndryshimet operationale.

4. Secila IFJB duhet të ketë një funksion të përhershëm dhe të pavarur të auditimit në mënyrë që të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara. Bordi i drejtorëve duhet të jetë përgjegjës që të sigurojë pavarësinë e funksionit të auditimit dhe që burimet e mjaftueshme materiale dhe njerëzore të jenë të disponueshme për kryerjen adekuate të funksioneve dhe detyrave të tij. Bordi i drejtorëve emëron Komitetin që mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm si dhe udhëheqësin e funksionit të auditimit të brendshëm apo kontraktimin e auditimit të brendshëm.
5. Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e audituara dhe nga proceset ditore të kontrollit të brendshëm. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm do të ketë kompetencë të komunikojë me bordin e drejtorëve drejtpërdrejt dhe me iniciativën e vet ose përmes Komitetit që mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm, i cili gjithashtu do të vendos për kompensimin e tij.
6. Auditori i brendshëm do të miratohet nga BQK-ja në pajtim me përcaktimet për menaxher të lartë në Rregulloren për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jobankare.
7. Vendimin mbi dorëheqjen ose largimin e udhëheqësit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe shkaqet e saj do t'i komunikohen BQK-së brenda shtatë ditëve të punës pas vendosjes.
8. Secila IFJB duhet të ketë një statut të shkruar të auditimit që përcakton mandatin dhe autorizimet e funksionit të auditimit të brendshëm brenda institucionit.
9. Statuti i auditimit të brendshëm duhet të përmbajë së paku këto elemente:
 - 9.1 Objektivat dhe fushëveprimin e funksionit të auditimit të brendshëm;
 - 9.2 Pozicionin e funksionit të auditimit të brendshëm brenda organizatës, autorizimet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet me funksionet tjera kontrolluese; dhe
 - 9.3 Përgjegjësinë e udhëheqësit të funksionit të auditimit të brendshëm.
10. Statuti i auditimit duhet hartohet dhe të rishikohet periodikisht nga funksioni i auditimit të brendshëm, të miratohet nga komiteti që mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm dhe më pas të konfirmohet nga bordi i drejtorëve si pjesë e rolit të tij mbikëqyrës.
11. Statuti i auditimit duhet t'i jap mandat auditimit të brendshëm, duke e autorizuar atë që të iniciojë dhe të ketë qasje dhe të komunikojë me çdo anëtar ose staf, të ekzaminojë çdo aktivitet ose entitet të IFJB-së, si dhe të ketë qasje në çdo regjistër, dosje ose të dhëna, përfshirë informacionet e menaxhmentit dhe procesverbalet e të gjitha trupave konsultative dhe vendimmarrës, kurdo që është e rëndësishme për kryerjen e detyrave të tij.
12. Statuti duhet të përcaktojë termat dhe kushtet për funksionin e auditimit të brendshëm për të ofruar shërbime këshilluese ose të përmbushë detyra tjera specifike.
13. Kompetenca profesionale e çdo auditori të brendshëm dhe e funksionit të auditimit të brendshëm si tërësi, e cila do të ndryshoj varësisht nga madhësia dhe ndërlikimi i operacioneve të IFJB-së, është thelbësore për funksionimin adekuat të funksionit të auditimit të brendshëm.

14. Anëtarët e funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përmbushin se paku cilësitë dhe aftësitë si në vijim:
 - 14.1 Aftësi profesionale për të implementuar dhe për të zbatuar standardet procedurale dhe teknikat e auditimit në fushat operuese të IFJB-së;
 - 14.2 Njohuritë dhe / ose përvojë mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
 - 14.3 Njohuri të parimeve për administrimin e rreziqeve dhe teknikave të matura të auditimit të brendshëm të IFJB-së.
15. Udhëheqës i funksionit të auditimit të brendshëm do të zgjidhet një individ me reputacion të lartë etik dhe profesional dhe me kualifikim dhe përvojë adekuate në fushën e auditimit.
16. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përgatisë një plan të auditimit për caktimin dhe kryerjen e detyrave, i cili do të miratohet nga bordi i drejtorëve dhe/ose komiteti i cili mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm. IFJB do të ofroj burimet e nevojshme për funksionin e auditimit të brendshëm.
17. Plani vjetor i auditimit duhet të përfshijë në detaje kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e punëve të planifikuara të auditimit të brendshëm, burimet e nevojshme sa i përket personelit, si dhe duhet të bazohet në një vlerësim të kontroleve të brendshme dhe mbi një vlerësim të shkruar të rreziqeve materiale të azhurnuara për çdo vit ushtrimor.
18. Raportet e funksionit të auditimit të brendshëm, të cilat përmbajnë gjetjet dhe rekomandimet si dhe përgjigjet e menaxherëve të lartë, duhet t'i prezantohen komitetit që mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm dhe/ose bordit të drejtorëve.
19. Raportet dhe letrat e punës së auditimit të brendshëm duhet të mbahen për së paku pesë vite, nga data e raportimit.
20. Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të përcjellë rekomandimet e tij për të verifikuar nëse ato janë zbatuar.

Neni 10

Kontraktimi i auditimit të brendshëm

1. Një marrëveshje kontraktuese e auditimit të brendshëm mund të kontraktohet ndërmjet një IFJB-je dhe një profesionisti të kualifikuar ose një shoqërie tregtare që si aktivitet primar ka ofrimin e shërbimeve profesionale që lidhen me auditimin e brendshëm. Në këto raste, shoqëria tregtare duhet të ketë të punësuar se paku një profesionist të kualifikuar që i plotëson kriteret e kësaj rregulloreje për udhëheqësin e auditimit të brendshëm.
2. Pavarësisht nga kushtet kontraktuese, bordi i drejtorëve do të mbetet përfundimisht përgjegjës për të siguruar se funksioni i auditimit të brendshëm është adekuat dhe operon në mënyrë efektive;
3. Të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje mbesin të zbatueshme në rastet kur aktivitetet e auditimit të brendshëm kontraktohen.

4. Shoqëria tregtare e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e kontraktuar për funksionin e auditimit të brendshëm duhet të miratohet nga BQK-ja.
5. Nëse e vlerëson të nevojshme, BQK-ja rezervon të drejtën për t'i kërkuar IFJB-së themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm brenda strukturës së IFJB-së, duke përjashtuar mundësinë e kontraktimit të auditimit të brendshëm.

Neni 11

Dënimet dhe masat përmirësuese

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Neni 12

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet dispozita e nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Rregullores për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jobankare.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit.

Flamur Mrasori
Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore